


Tregtia e jashtme e mallrave

Maj 2020

Tiranë, më 17 Qershor 2020: Në Maj 2020 eksportet e mallrave arritën vlerën 21 mld lekë, duke u ulur me 22,7 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe duke u rritur me 43,8 %, në krahasim me Prill 2020. Importet e mallrave arritën vlerën 45 mld lekë, duke u ulur me 24,2 %, në krahasim me një vit më parë dhe duke u rritur me 22,9 %, në krahasim me Prill 2020. Deficiti tregtar i këtij muaji është 23 mld lekë, duke u ulur me 25,6 %, krahasuar me Maj 2019 dhe duke u rritur me 8,3 %, në krahasim me Prill 2020.

Fig. 1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)




Në pesëmuajorin e parë 2020 eksportet e mallrave arritën vlerën 102 mld lekë, duke u ulur me 19,4 %, krahasuar me një vit më parë dhe importet e mallrave arritën vlerën 219 mld lekë, duke u ulur me 17,1 %, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 117 mld lekë, duke u ulur me 14,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2019.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:

Rënia vjetore e eksporteve prej 22,7 %, këtë muaj është ndikuar nga grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -8,6 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -8,0 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -5,4 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të eksporteve ka ndikuar pozitivisht grupi: “Ushqim, pije, duhan” me +2,6 pikë përqindje.

Fig.2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Maj 2020




Eksportet, gjatë këtij pesëmuajori janë ulur me 19,4 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar negativisht në uljen vjetore të eksporteve, janë: “Tekstile dhe këpucë” me -10,1 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -5,1 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -3,4 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të eksporteve ka ndikuar pozitivisht grupi: “Ushqim, pije, duhan” me +0,4 pikë përqindje dhe “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +0,2 pikë përqindje.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:

Rënia vjetore e importeve prej 24,2 %, këtë muaj është ndikuar kryesisht nga grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -6,5 pikë përqindje, “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me -5,1 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -4,8 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të importeve ka ndikuar pozitivisht grupi: “Produkte kimike dhe plastike” me +0,03 pikë përqindje.

Fig.3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Maj 2020



Si pesëmujor, importet janë ulur me 17,1 %, krahasuar me pesëmujorin e parë 2019. Grupet që kanë ndikuar negativisht në uljen vjetore të importeve, janë: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -4,8 pikë përqindje, “Makineri, pajisje, pjesë këmbimi” me -4,7 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -3,9 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të importeve ka ndikuar pozitivisht grupi: “Ushqim, pije, duhan” me +0,4 pikë përqindje.

Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere


Në muajin Maj 2020, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Maj 2019 janë: Gjermania (11,9 %), Serbia (39,9 %), dhe Franca (157,1 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe janë: Italia (-29,8 %), Kosova (-39,2 %) dhe Greqia (-31,0 %).

Gjatë këtij pesëmujori vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Gjermania (16,6 %), Serbia (11,8 %), dhe Franca (26,9 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Italia (-26,6 %), Kosova (-34,3 %) dhe Spanja (-6,5 %).

Në muajin Maj 2020, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me Maj 2019 janë: Rusia (+87,0 %), Ukraina (+666,0 %), dhe Holanda (+29,3 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Italia (-21,8 %), Greqia (-18,8 %) dhe Kina (-29,5 %).

Gjatë këtij pesëmujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Rusia (50,8 %), Holanda (0,2 %) dhe Ukraina (82,0 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Italia (-23,1 %), Greqia (-11,8 %) dhe Turqia (-13,8 %).

Fig. 4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Maj 2020



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE-së zënë 62,5 %, të gjithë tregtisë. Në Maj 2020, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 70,3 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 58,7 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (32,0 %), Greqia (7,9 %), Kina (7,4 %) dhe Turqia (6,6 %).

Shkëmbimet tregtare, për pesëmuajorin e parë 2020, me vendet e BE-së zënë 63,2 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar – Maj 2020, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 76,0 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 57,3 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (30,7 %), Greqia (7,8 %), Gjermania (7,6 %) dhe Turqia (6,4 %).

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave

Vitet	Muajt	Eksporte (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Importe (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Bilanci Tregtar (mld lekë)	Mbulimi (%)
2000		37	-23,5	157	-1,5	-120	23,6
2001		44	19,1	190	21,0	-146	23,2
2002		47	7,7	210	10,6	-163	22,6
2003		54	14,7	226	7,4	-172	24,1
2004		62	14,0	236	4,5	-174	26,3
2005		66	6,0	262	11,1	-196	25,1
2006		77	17,6	299	14,1	-222	25,9
2007		97	25,5	376	25,8	-279	25,8
2008		113	15,8	440	16,9	-327	25,6
2009		105	-7,2	429	-2,5	-324	24,4
2010		162	54,6	478	11,4	-316	33,8
2011		197	21,9	544	13,9	-347	36,2
2012		213	8,2	528	-2,9	-315	40,3
2013		246	15,7	517	-2,1	-271	47,6
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2017		273	12,1	626	8,1	-353	43,6
2018		310	13,7	641	2,4	-331	48,4
2019		299	-3,8	649	1,2	-350	46,0
2018	01 - 18	24	24,5	45	27,5	-21	52,5
	02 - 18	24	18,8	46	4,4	-22	52,0
	03 - 18	27	14,6	55	2,5	-28	49,0
	04 - 18	27	11,3	53	5,2	-26	50,9
	05 - 18	30	24,3	57	2,1	-27	53,1
	Janar – Maj 18	131	18,5	255	7,0	-124	51,5
2019	01 - 19	22	-7,3	42	-6,2	-20	51,9
	02 - 19	23	-5,3	50	8,5	-27	45,4
	03 - 19	28	2,7	56	1,4	-28	49,6
	04 - 19	27	0,1	57	8,9	-30	46,7
	05 - 19	28	-8,0	59	4,0	-31	47,0
	Janar - Maj 19	127	-3,5	264	3,5	-137	48,0
2020	01 - 20	23	5,3	42	-0,4	-19	54,9
	02 - 20	25	10,6	52	3,9	-27	48,3
	03 - 20	18	-36,0	44	-20,8	-27	40,1
	04 - 20	15	-44,2	36	-36,4	-21	41,0
	05 - 20	21	-22,7	45	-24,2	-23	48,0
	Janar –Maj 20	102	-19,4	219	-17,1	-117	46,6

Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë)

	Eksporte				Importe			
	Maj 2019	Maj 2020	Jan. - Maj 2019	Jan. - Maj 2020	Maj 2019	Maj 2020	Jan. - Maj 2019	Jan. - Maj 2020
Vendet e BE-së	20.554	15.075	96.793	77.644	34.272	26.272	155.630	125.496
Austri	100	110	895	671	578	400	3.052	1.961
Gjermani	1.294	1.448	5.895	6.874	4.181	2.520	18.008	17.668
Greqi	1.252	863	5.296	4.610	5.335	4.334	23.318	20.574
Itali	13.198	9.259	63.174	46.377	15.263	11.930	67.860	52.160
Spanjë	1.901	468	7.887	7.377	957	655	4.666	3.526
Kroaci	94	138	462	759	678	517	2.737	2.118
Të tjera të BE-së	2.715	2.788	13.186	10.977	7.281	5.915	35.990	27.489
Mbretëri e Bashkuar	60	109	330	336	498	435	2.104	6.629
Kinë	721	644	2.721	2.278	5.989	4.221	24.655	18.306
Kosovë	3.118	1.896	12.075	7.930	840	730	3.020	2.701
Maqedonia e Veriut	757	728	3.572	3.057	832	697	3.514	3.253
Rusi	12	-	70	6	569	1.064	4.719	7.115
SHBA	244	269	1.766	1.310	1.151	513	4.534	3.748
Turqi	87	155	882	851	5.582	4.199	22.946	19.786
Ukrainë	6	60	94	229	126	966	1.189	2.163
Zvicër	49	34	337	345	1.458	757	7.144	4.683
Të tjera	2.145	2.484	8.142	8.221	7.710	4.867	34.791	25.286
Gjithsej	27.752	21.453	126.782	102.207	59.028	44.721	264.247	219.167

Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë)

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Maj 2019	Maj 2020	Jan. - Maj 2019	Jan. - Maj 2020	Maj 2019	Maj 2020	Jan. - Maj 2019	Jan. - Maj 2020
Gjithsej	27.752	21.453	126.782	102.207	59.028	44.721	264.247	219.167
Ushqime, pije, duhan	3.739	4.464	14.346	14.846	9.204	8.853	43.266	44.318
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	4.962	2.566	19.834	15.527	7.038	3.173	33.610	20.989
Produkte kimike dhe plastike	671	544	2.962	2.776	7.693	7.709	35.256	34.099
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	235	148	1.073	887	1.910	1.111	7.776	4.884
Prodhime druri dhe letre	825	553	3.943	3.298	2.404	2.129	9.843	9.000
Tekstile dhe këpucë	10.439	8.229	51.662	38.817	8.507	5.660	36.156	25.763
Materiale ndërtimi dhe metale	4.381	2.894	20.383	13.891	8.062	5.654	33.226	29.335
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	1.666	1.434	8.873	9.088	11.954	8.952	55.542	43.163
Të tjera	833	621	3.707	3.078	2.257	1.482	9.571	7.616

Tab. 4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë)

	Itali		Kosovë		Spanjë		Gjermani	
	2019	2020	2019	2020	2019	2020	2019	2020
Gjithsej	63.174	46.377	12.075	7.930	7.887	7.377	5.895	6.874
Ushqim, pije duhan	3.338	3.497	1.523	1.472	553	456	509	527
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	2.884	436	2.933	1.124	6.286	6.332	508	419
Produkte kimike dhe plastike	796	768	804	812	14	65	29	23
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	856	737	4	2	100	67	6	4
Prodhime druri dhe letre	2.765	1.946	322	301	3	2	60	217
Tekstile dhe këpucë	40.425	28.462	32	49	823	382	3.085	3.920
Materiale ndërtimi dhe metale	6.194	4.811	5.516	3.236	102	53	675	621
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	4.285	4.454	302	253	3	7	675	804
Të tjera	1.631	1.266	639	682	2	13	346	338

Tab. 5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë)

	Itali		Greqi		Turqi		Kina	
	2019	2020	2019	2020	2019	2020	2019	2020
Gjithsej	67.860	52.160	23.318	20.574	22.946	19.786	24.655	18.306
Ushqim, pije duhan	7.791	7.821	6.187	6.450	2.333	2.305	349	288
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	3.053	1.415	6.135	3.958	358	638	1	4
Produkte kimike dhe plastike	7.522	6.889	3.116	3.030	3.086	3.307	2.155	2.173
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	6.236	4.004	16	11	103	76	325	179
Prodhime druri dhe letre	2.792	2.336	1.297	1.313	1.269	1.093	404	299
Tekstile dhe këpucë	17.373	11.506	1.545	1.347	7.113	5.173	4.598	3.293
Materiale ndërtimi dhe metale	8.040	6.359	3.293	2.911	4.844	3.823	4.174	2.433
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	12.981	10.310	1.078	990	2.988	2.761	10.418	7.903
Të tjera	2.070	1.519	651	565	853	609	2.230	1.735

Përkufizime

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë. të vendosura nën regjimin doganor. në përpunimin pasiv ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues. pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë. të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë. për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues. pra përfshin koston e mallit edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri